

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI  
i  
"NOVAMED" Shpk**

**KAPITULLI I**

**Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja**

**Neni 1  
Data e Themelimit dhe Emri**

1.1. Sot me date **07.03.2021** themelohet nga ortaku/ortaket themelues, sipas legjislacionit shqiptar, shoqeria me perjegjesi te kufizuar "NOVAMED" (ne vijim "Shoqeria"), e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk".

1.2. Ortaku/Ortaket i/e Shoqerise ("Ortaku"/"Ortaket") gezojne perjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuote/a.

1.3. Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga :

- fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk".
- numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj.
- adresa e regjistruar;
- pasqyrimi i faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, nese aplikohet.
- kapitalin e regjistruar dhe te paguar te Shoqerise.


**Neni 2  
Forma Ligjore**

2.1. Shoqeria eshte nje person juridik shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar ("shoqeri me perjegjesi te kufizuar"), ne pajtim me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("Ligji per Shoqerite Tregtare").

**Neni 3  
Selia**

3.1. Ne momentin e nenshkrimit te ketij akti, selia e Shoqerise ndodhet ne adresen:

- Rruga "Nikolla Zoraqi", Ndertesa Nr. 19, Kt. 1, Tirane, Shqiperi.



3.2 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

**Neni 4  
Kohezgjatja**

4.1. Kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar.

**KAPITULLI II**

**Neni 5  
Objekti i Shoqerise**

5.1. Objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte kryerja e çdo aktivitet tregtar te lejuar nga legjislacioni Shqiptar, dhe veçanerisht:

Import-Eksport i mallrave dhe produkteve te ndryshme perfundimtare farmaceutike, kozmetike, bimore dhe ushqimore, Import - Eksport te lendeve te para, ndihmese, ambalazheve dhe i materialeve, qe perdoren per prodhimin dhe konfektionimin e barnave.  
Perpunimin, importimin, eksportimin, tregtimin e produkteve farmaceutike gjysem te gatshme.  
Tregtimin, importimin dhe eksportimin e materialeve te konsumit mjekesor dhe pajisjeve mjekesore.  
Zhvillimin e aktiviteve per promocijn marketing mjekesor dhe farmaceutik.  
Sherbime kerkimore dhe zhvillimore ne industrine farmaceutike; kozmetike dhe ushqimore dhe cdo aktivitet tjeter te lejuar me ligj.

5.2. Perveç kesaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperm.

**Neni 6  
Ndryshime**


6.1. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimitarise se saj ne çdo kohe siç parashikohet ne kete Statut.

**KAPITULLI III**  
**Kapitali Themeltar; Kuotat e Kapitalit Themeltar**

**Neni 7  
Kapitali Themeltar**

7.1. Kapitali i Shoqerise eshte ne total 100 (njeqind) Leke) i zoteruar teresisht ne 2 (dy) kuote/a (me tej "Kuota"/"Kuotat")

  
2



**Neni 8**  
**Ortaku/Ortaket dhe Kuota/Kuotat**

8.1. Ne daten e themelimit Shoqeria ka 2 (dy) Ortak i cili/te cilet ka nenshkruar dhe zoteron Kuoten/Kuotat e Shoquerise, si me poshte:

- *ISUF BERBERI, shtetas shqiptar, lindur me 24.08.1969, ne Vlore, mbajtes i leternjoftimit me nr.036364385, banues ne: Rruga," Dervish Hima"; Nd. Kulla 1; H. 1; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 2; 1003; Tiranë zoteron 80% te kapitalit te perbere prej nje kuote te vetme ne vlera prej 80 (tetedhjete) ne leke).*
- *EDI GRABOCKA, shtetas Shqiptar, lindur më 14/04/1971, në Fier dhe banues ne adresë: Rr "Arkitekt Kasemi" Pall 36/2 Ap; Nd. 16; Njësia Administrative Nr. 2; 1001; Tiranë, mbajtes i pasaportes Nr. BC1434432 zoteron 20% te kapitalit te perbere prej nje kuote te vetme ne vlera prej 20 (njezet) ne leke).*

**Neni 9**  
**Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar**

9.1. Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Ortakeve ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit per Shoquerite.

9.2. Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit.

9.3 Rritja e kapitalit do te behet me leshimin e kuota te reja apo me rritjen e vleres se kuotave ekzistuese. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkuhen dhe vlera e tyre do te paguhet plotesisht.

9.4. Shoqeria nuk mund te bleje asnje kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoquerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Ortaket mund te autorizojne Administratorin/ret te bejne blerjen e kuotat perkatese apo pjese te tyre dhe ti anulojne ato.

**Neni 10**  
**Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve**

10.1. Ortaket jane vetem ata te cilet zoterojne kuota ne Shoqeri.

10.2. Çdo Ortak do te kete te dejta vote ne perpjestim me perqindjen e kontributit te zoteruar prej tij ne kapitalin e Shoquerise dhe qe perfaqeshet nga Kuota e tij ose pjese e Kuotes se tij. Çdo Ortak ka te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoquerise, sikunder te drejtat e parashikuara nga ky Statut, dhe dispozitave ligjore te Ligjit per Shoquerite.

10.3. Ortakut do t'i jepen, pas kerkeses me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoquerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoquerise.

10.4. Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotes/tave, transferohen tek çdo zoterues i ri per keto Kuota.

10.5. Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaku mban pergjegjesi brenda limitit te vleres se Kuotes qe zoteron. Ortaku nuk mban pergjegjesi mbi vleren e investimit te tij ne kapitalin e Shoqerise (perveç garancive dhe huave qe ata leshojne).

10.6. Shoqeria nuk mban pergjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te tij.

#### **KREU IV**

##### **Asambleja e Ortakeve/Ortaku i Vetem**

###### **Neni 11 Kompetencat**

11.1. Asambleja/Ortaku i Vetem eshte organi vendim marres i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtarie.

###### **Neni 12 Mbledhja**

12.1. Asambleja/Ortaku i Vetem duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.

12.2. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

12.2. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane një vlore me te larte se 5% e te gjithe aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja/Ortaku i Vetem do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t'i paraqitet, pervec rastit kur kjo blerje behet ne burse ose ben pjesë ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

12.4. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga ortaku pasuri, qe kane vlore me te larte se 5% e aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

12.5. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja/Ortakut te Vetem i paraqitet një raport nga një ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne burse ose ben pjesë ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

12.6. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja/ Ortaku i Vetem mund te miratoje një rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e Administratoreve.

**Neni 13**  
**Menyra e Thirrjes**

13.1. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara tij nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

13.2. Asambleja/Ortaku i Vetem mund te mblidhet nga nje prej Administratoreve ose me iniciativen e tij.

13.3. Asambleja/Ortaku i Vetem mblidhet ne seline e Shoqerise, ose ne ambientet e deges se Shoqerise apo ne cdo qytet, province apo shtet tjeter, siç bihet dakord nga Asambleja/Ortaku. Vend i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve i njoftohet Ortakut/Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes, se bashku me dokumentat e nevojshme te lidhura me ceshtjet e rendit te dites. Ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem nuk eshte mbledhur/thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem eshte dakort.

13.4. Ortaku gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjeter ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

13.5. Ortaku ka te drejten te votoje ne perputhje me vleren e Kuotes se zoteruar prej tij ne kapital.

13.6. Vendimet e meposhtme do te merren me nje kuorum prej me shume se  $\frac{1}{2}$  e kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje:


- vendimet ne lidhje me mos shperndarjen e fitimeve apo/dhe me destinacionin e ndrs hem te fitimeve te Shoqerise;
- ndryshimi i Statutit;
- likujdim ose riorganizmin e Shoqerise;
- zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise;

Çdo vendim tjeter do te merret me nje kuorum prej me shume se 30% te kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne 51% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje.

13.7. Ortaku/Ortaket do te njoftohen per permbajtjen e axhendes se mbledhjes.



A handwritten signature consisting of a stylized 'J' shape with a small '5' written below it.



A handwritten signature consisting of a large, open 'A' shape with a horizontal line extending from its right side.

13.8. Administratori/ret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit per Shoqerite dhe do te regjistrojne te gjitha vendimet e marra ne Regjistrin e Vendimeve.

**Neni 14**  
**Perjashtimi nga e drejta e votes**

14.1. Nje Ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur eshte duke vendosur mbi:

- vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
- shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
- dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

14.2. Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresoitet te jete ne te njejtin konflikt interes i sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

**KREU V**  
**Administratori/ret**

**Neni 15**  
**Administratoreve dhe kompetencat**

15.1. Shoqeria mund te administrohet nga nje ose me shume Administrator/re, sipas vendimit te Asamblese/Ortakut te Vetem. Administratori/ret mund te jete i cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jete rezident ne Shqiperi.

15.2. Ne momentin dhe per qellimin e miratimit te ketij statuti administrator i Shoqerise eshte:

- Z.EDI GRABOCKA, shtetas shqiptar, lindur me 14.04.1971, mbajtes i kartes se identitetit/pasaportes Nr. BC1434432, i cili emerohet per nje periudhe prej 5 (pese) vjetesh nga data e themelimit te Shoqerise, te percaktuar ne kete dokument. Cdo ndryshim i mepaseshem ne lidhje me emerimin e Administratorit/reve nuk do te konsiderohet si nje ndryshim Statuti.

15.3. Administratori/ret emerohen per nje periudhe prej 5 (pese) viti/vjetesh, te rinovueshme. Ne rast te me shume se nje Administratori kompetencat e qe do te ushtrohen vecmas nga secili prej Administratoreve, nese ky eshte rasti, do te percaktohen ne vendimin e Asamblese/Ortakut te Vetem qe emeron Administratorin.

15.4. Menjehere pas pranimit te emerimit te tij/tyre, Administratori(et) njojin ne se marredhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje vendimi te Asamblese/Ortakut i Vetem gjykohet si arsy e ligjshme per shkarkimin e tyre nga puna, ne perputhje me ligjet perkatese.



6



15.5. Asambleja/Ortaku i Vetem ka te drejte te shkarkoje Administratorin(ret) ne cdo moment.

15.6. Nese Administratoret e Shoqerise nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, çeshtja do te referohet tek Asambleja/Ortaku i Vetem.

15.7. Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria mund t'u rimbursoje Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Administratorit(eve) ne vende qe nuk jane brenda qytetit te residences se Administratorit(eve).

**Neni 16**  
**Kompetencat dhe detyrimet e Administratorit/reve**

16.1. Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- (i) kerkesa/thirrjea e mbledhjes se Asamblese/ Ortakut te Vetem, ne rastet e specifikuara ne nenin 13;
- (ii) menaxhimin e aktivitetit te perditshem tregtar te Shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja/Ortaku i Vetem;
- (iii) perfaqesimin e Shoqerise me palet e treta;
- (iv) kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise;
- (v) pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim tek Asambleja/Ortaku i Vetem;
- (vi) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare e Biznesit, kur eshte e nevojshme;
- (vii) raportimin perpara Asamblese/Ortakut te Vetem, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;
- (viii) kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Asambleja/Ortaku i Vetem.

16.2. Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaku ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaku.

**Neni 17**  
**Detyrimi i besnikerise dhe perpjegjesia**

17.1. Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e perpjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,16,17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, administratoret detyrohen:

- (i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
- (ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- (iii) te vleresojne me perpjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
- (iv) te parandaloje dhe menjanoste rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;
- (v) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

17.2. Administratoret perpjigjen kundrejt shoqerise per cdo veprim apo mosveprim, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.

17.3. Ne rast te shkeljes se detyres dhe standardeve profesionale, sipas pikave 17.1 dhe 17.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se një Administrator ata perpjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.

17.4. Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqoftese ne kundershtim me Ligjin per Shoqerite kryen veprimet e meposhtme:

- (i) i kthen Ortakeve kontributet;
- (ii) i paguan Ortakeve interesa apo dividente;
- (iii) i shperndan asetet Shoqerise;

  
8



(iv) lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitein e saj, kur duhet ta kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj;

(v) jep hua;

**KREU VI**  
**Administrimi Financiar i Shoqerise**

**Neni 18**  
**Eksperti Kontabel i Autorizuar**

18.1 Ortaku cakton ekspertin kontabel te autorizuar (auditues) per te dhene sherbimet e tij kudrejt Sho qerise.

18.2. Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjisacionin shqiptar.

**KREU VII**  
**Aktiviteti Shoqerise**

**Neni 19**  
**Viti ekonomiko-financiar**

19.1. Viti ekonomiko-financiar fillon ne diten e pare te muajit Janar dhe perfundon ne diten e 31-te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne daten e themelimit te Shoqerise.

**Neni 20**  
**Mbajtja e Llogarive**

20.1. Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.



**Neni 21**  
**Llogaritja dhe Shprendarja e Fitimit**

21.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te pasqyrave financiare te aprovar nga Asambleja/Ortaku i Vetem. Cdo ndryshim ne destinacionin e fitimit do te caktohet nga Asambleja/Ortaku i Vetem ne perputhje me Statutin dhe me ligjet e zbatueshme.

21.2. Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:

(i) asetat e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;

(ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem;



21.3. Administratoret leshojne një certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 21.2 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush kerkesat sipas 21.2, Administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

21.4. Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

**KREU VIII**  
**Modifikimi i Formes Ligjore dhe Prishja**

**Neni 22**  
**Modifikimi i Formes Ligjore**

22.1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese/Ortakut te Vetem ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.


22.2. Shoqeria do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit te nevojshme ne Shqiperi per kete qellim.

**Neni 23**  
**Prishja e Shoqerise**

23.1. Shoqeria mund te prishet ne rrethanat e meposhtme:

- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) me vendim te Asamblese/Ortakut te Vetem;
- (iii) me hapjen e nje procedure falimentimi;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me pikën 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (v) me vendim gjykate;
- (vi) per arsyte tjera te parashikuara nga Asambleja/Ortaku i Vetem ne cdo kohe.

23.2. Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njoftimin vendimin kesaj te fundit per regjistrim.



10



**KREU IX**  
**Te ndryshme**

**Neni 24**  
**Largimi i Ortakut**


24.1. Largimi dhe perjashtimi i një Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga dispozitat nr. 101, 102, 103 te Ligjit per Shoqerite Tregtare.

**Neni 25**  
**Te tjera**

25.1. Cdo ceshjtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

**ORTAKU**

**ISUF BERBERI**



**EDI GRABOCKA**

